



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0286
Data e Vendimit: 12.05.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Sankos" Sh.p.k. kundër njoftimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-26-1564-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, Ardian Behra, me datën: 12. 05. 2026, mori këtë:

Vendim

I. Refuzohet si e parakohshme, ankesa e OE "Sankos" Sh.p.k me nr. të protokollit 2026/0286, e datës 04.05.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-26-1564-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar pagesë të tarifës më rastin e parashtrim të ankesës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 04.05.2026, ka pranuar ankesën e OE "Sankos" Sh.p.k lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-26-1564-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 24.03.2026, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ku hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 04.05.2026.

Operatori Ekonomik "Sankos" Sh.p.k, me 04.05.2026, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 0286/2026 (Nr. protokolli) kundër njoftimit të AK-së.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-26-1564-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, njoftimi për kontratë është publikuar me datën 24.03.2026, ndërkaq sipas formularit Standard për Korrigjim të gabimeve të datës 29.04.2026, hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 04.05.2026.

Operatori Ekonomik "Sankos" Sh.p.k, me 04.05.2026, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 0286/2026 (Nr. protokolli) kundër njoftimit të AK-së.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, konstatohet se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të parakohshme për faktin se sipas nenit 109 të LPP-së operatori ekonomik mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së vetëm pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim në Autoritet Kontraktues e që në rastin konkret vërtetohet se OE nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim për këtë procedurë prokurimi.

Sipas nenit 109 të LPP-së kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu, edhe me nenin 64 par 1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohet se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të parakohshme sepse nuk ka respektuar dispozitat ligjore të shtjelluara si më lartë, andaj i lejon autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-26-

1564-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Poashtu, ankuesi për këtë ankesë nuk ka paguar tarifë ashtu siç është paraparë me nenin 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik ku thuhet se çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: “1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet”.

Kryesuesi i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " Sankos " Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: